

Konsultime publike për komponentët kryesore të Reformës në Drejtësi

Në zbatim të filozofisë së gjithëpërfshirjes në të gjitha etapat e procesit të Reformës në Drejtësi, Komisioni i Posaçëm Parlamentar dhe Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë synon që përmes këtyre aktiviteteve të prezantojë kapitujt kryesorë të Dokumentit Analitik, si dhe të marrë mendime, sugjerime dhe opinione konkrete nga të gjithë të interesuarit, për t'i pasqyruar më pas ato në paketën e propozimeve për Reformën. Takimi i parë pritet të zhvillohet më 16 qershor në mjediset e Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformës në Drejtësi dhe Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë do të zhvillojnë nga data 16 qershor deri më 9 korrik 2015 konsultime publike në qytetet e Shkodrës, Vlorës, Durrësit, Korçës, Pogradecit e Tiranës, kryesisht në qendrat universitare. Në fokus të diskutimeve do të jenë problematikat dhe gjetjet e komponentëve kryesorë të Reformës, si gjyqësori, edukimi ligjor, drejtësia penale, kushtetuesja, masat anitkorrupsion, shërbimet ligjore dhe financimi i sistemit të drejtësisë.

Në këto konsultime publike do të jenë pjesmarrës grupet lokale të interesit, gjyqtarë, prokurorë, noterë, avokatë, por dhe studentë e pedagogë të degës së drejtësisë dhe nga shkencat shoqërore, aktivistë dhe drejtues të organizatave jofitimprurëse, medias etj.

Dy takimet e para konsultuese do të zhvillohen në qytetet e Shkodrës dhe të Vlorës, në datat 16 dhe 25 qershor 2015, të cilat do të përqëndrohen tek dy kapitujt e Dokumentit Analitik që lidhen me edukimin ligjor dhe arsimin juridik, si dhe për çështjet kushtetuese. Për temën e parë të ftuar në bashkëbisedim do të jenë studentë dhe pedagogë nga Universiteti “Luigj Gurakuqi”, ndërkohë që për të dytën në auditor, veç studentëve dhe pedagogëve të Universitetit “Ismail Qemali”, do të jenë dhe gjyqtarë, prokurorë, nga dhomat e noterisë dhe avokatisë në Vlorë, përfaqësues të shoqërisë civile etj.

Sipas një kalendari të miratuar nga grupet e punës, konsultimet publike do të vijojnë dhe në Universitetin “Aleksandër Moisiu” në Durrës, në Universitetin “Fan S. Noli” në Korçë, në Universitetin e Tiranës në kryeqytet dhe në qytetin e Pogradecit.